



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prizemja Në/Cena 02-05-2014			
Nr./organi: Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01	013/594		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika a të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03L-040, lidhur me nenin 35, paragrafi 2, pika a në koordinim me nenin 36, paragrafi 2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiëve propozon këtë:

RREGULLORE

Për punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë rregullore rregullohet mënyra e punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë, e komiteteve, e komisioneve dhe e trupave tjerë punues të themeluar nga Kuvendi, mbledhjet dhe kuorumi, pjesëmarrja e publikut në mbledhje, rregullat e debateve, votimi, si dhe mënyra e vendosjes dhe e sjelljeve që do të konsiderohen se janë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 2

Neni 2

Përkufizimi

1. Nocionet:

- 1.1. **(LVL)** - nënkupton Ligjin për Vetëqeverisjes Lokale;
- 1.2. **(Statut)** - nënkupton aktin më të lartë normativ të Komunës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë;
- 1.3. **(Kuvend)** - nënkupton Kuvendin e Komunës;
- 1.4. **(Komitet)** - nënkupton komitetet e përhershme dhe komitetet tjera të themeluara nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me rregulloren dhe Statutin e Komunës;
- 1.5. **(Komision/e)** - nënkupton komisionet apo trupat tjerë punuese të përhershëm, apo të përkohshëm, të themeluara sipas nevojës nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me Statutin;
- 1.6. **(Anëtar)** - nënkupton anëtarin e Kuvendit të zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit, apo i emëruar (zëvendësuar) në pajtim me ligjin për zgjedhjet në fuqi;
- 1.7. **(Kryetar i Komunës)** - nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejt nga votuesit, që kanë të drejtë vote në Komunë, në përputhje me Ligjin-Rregulloren për zgjedhjet komunale që është në fuqi;
- 1.8. **(Kryesues)** - nënkupton kryesuesin e Kuvendit, të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës;
- 1.10. **(Grup i anuarve të kuvendit)** - nënkupton grupin e anëtarëve, që përbëhet prej së paku tre anëtarëve të Kuvendit, që udhëhiqet prej shefit të grupit parlamentar, i cili emërohet nga vet anëtarët e atij grupi parlamentar.
- 1.11. **(Drejtor)** - nënkupton të emëruarin politik, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ana e kryetarit të Komunës për mandat të njëjtë me kryetarin e Komunës, i cili drejton një drejtori të caktuar.

Neni 3

Mbledhja inauguruese

1. Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës do të caktohet në pajtim me nenin 42 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40.

Neni 4

Betimi

1. Betimi i kryetarit të Komunës procedohet në pajtim me nenin 57 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitave ligjore të Statutit të Komunës së Vitisë.

2. Betimi i anëtarëve të asamblesë komunale procedohet në pajtim me nenin 35, paragrafi 4 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040.

Neni 5

Kryesuesi i Kuvendit

1. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit bëhet në pajtim me nenin 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.
2. Kryesuesi i Kuvendit kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë së Kuvendit, në përputhje me ligjet pozitive dhe aktet me fuqi nënligjore, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe anëtarëve të tij.
3. Mbledhjet e Kuvendit i thërret dhe kryeson kryesuesi i Kuvendit.
4. Në mungesë të kryesuesit mbledhja e Kuvendit udhëhiqet nga anëtari më i vjetër i Kuvendit, apo nga ndonjë anëtarë që caktohet nga ana e kryesuesit.

Neni 6

Mbledhjet dhe kuorumi

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Kuvendit.
2. Kryesuesi mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës mund ti thërrasë në çdo kohë, sipas kërkesës së kryetarit të Komunës, apo me kërkesën e 1/3 (një të tretës) së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit. Kryesuesi i komitetit-komisionit mbledhjet e jashtëzakonshme të komitetit mund ti thërrasë në çdo kohë sipas kërkesës së kryetarit të Komunës apo 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të komitetit.
3. Së paku 7 ditë pune para çdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës, ndërsa për raste urgjente 3 ditë më herët anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe për rendin e ditës të propozuar për atë mbledhje. Në të njëjtën kohë për këtë duhet po ashtu të shpallet njoftimi publik. Anëtarët e komiteteve për mbledhjet do të njoftohen 7 ditë më parë. Lajmërimi për mbledhjet e komiteteve përfshin kohën, datën dhe vendin ku do të mbahen mbledhjet, si dhe rendin e ditës që propozohet për punën e mbledhjeve. Kryesuesi duhet të garantojë që këto kushte janë përmbushur për të gjitha mbledhjet e komiteteve dhe ato të Kuvendit. Duhet të publikojë njoftimin për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjeve, në çdo zyrë kryesore dhe në Zyrën e Komuniteteve. Në të njëjtën kohë ai duhet t'ua dorëzojë thirrjen për pjesëmarrje në mbledhje çdo anëtari të Kuvendit, respektivisht të komitetit, së bashku me propozimin e rendit të ditës, sipas së cilit përcaktohen çështjet që do të shqyrtohen në mbledhjet.
4. Kuvendi i Komunës dhe komitetet i mbajnë mbledhjet e tyre sipas kohës së rregullt, në pajtim planin e punës dhe dispozitat e Statutit.
5. Mbledhjet e Kuvendit, në pajtim me dispozitat e Statutit, gjithashtu mund të thirren nga 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur. Rendi i ditës i propozuar në kërkesën për thirrjen e mbledhjes mund të ndryshohet nga kryesuesi dhe as nga pjesëmarrësit tjerë të Kuvendit apo të komitetit.

6. Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve duhet të mbahet procesverbal. Procesverbal duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të pranishëm dhe të anëtarëve të fluar, rendin e ditës, çështjet të cilat janë diskutuar (thelbin e diskutimit), rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i çdo anëtar, në procesverbal duhet shënuar ashtu siç ka votuar secili. Procesverbalin e mban një shërbyes civil nga shërbimi profesional për punën e Kuvendit, i cili duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme, përjashtimisht në mbledhjen tjetër. Çdo i interesuar ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe të marrë një kopje me përjashtim të procesverbalit apo të pjesës së procesverbalit kur ka të bëjë me dispozitat e nenit 45, al.3 të LVL-së.
7. Për çdo anëtarë që merr pjesë në mbledhje duhet ti shënohet emri në librin e pjesëmarrësve ose në listën për personat e pranishëm të hartuar për këtë qëllim.
8. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komitetet e tij përbëhet nga më tepër se gjysma e anëtarëve prezent në mbledhje.
9. Kuvendi i Komunës dhe komitetet do ti trajtojnë vetëm çështjet të cilat janë në kompetencë të tyre.
10. Nëse kushtet e caktuara për mbajtjen e mbledhjes nuk përmbushen (si mungesa e kuorumit) asnjë nga pikat e rendit të ditës nuk do të shqyrtohen në mbledhje, përveçse në kushte të jashtëzakonshme, të cilat do të përshkruhen në procesverbalin e mbledhjes, kur Kuvendi, apo komiteti konsideron se çështja duhet të trajtohet urgjentisht.

Neni 7

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës për mbledhje caktohet nga kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me kryetarin e Komunës dhe në konsultim me kryesuesit e grupeve parlamentare, dhe se i njëjti duhet të shqyrtohet dhe të miratohet nga KPF-ja si rekomandim Kuvendit Komunal.
2. Rendi i ditës i mbledhjes zakonisht do të jetë ky:
 - 2.1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit;
 - 2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës i propozuar;
 - 2.3. Pyetjet dhe përgjigjet;
 - 2.4. Peticionet, kërkesat të cilat parashtrihen në mbledhje;
 - 2.5. Punët të cilat i obligon rregullorja, Statuti ose ligjet në fuqi për tu kryer në mbledhje;
 - 2.6. Çfarëdo çështje e shtruar nga kryesuesi i mbledhjes dhe temat që lindin aty për aty pas konsultimit paraprak;
 - 2.7. Çfarëdo pune e papërfunduar në takimin e fundit;
 - 2.8. Raportet dhe rekomandimet e marra nga komitetet dhe çfarëdo çështjesh të tjera që lindin si rezultat i atyre raporteve;

- 2.9. Raportet dhe rekomandimet e marra nga kryetari i Komunës dhe çështjet tjera që lindin si rezultat i atyre raporteve;
- 2.10. Çështjet që kanë të bëjnë me aktivitete të Komunës të shtruara nga ana e anëtarit/ëve, sipas rendit të miratuar të ditës;
- 2.11. Propozimet e shtruara nga ana e anëtarit sipas radhës së pranimi të tyre, përveç në rastet kur mbledhja thirret nga ana e 1/3 (një të tretës) së anëtarëve si e jashtëzakonshme;
- 2.12. Pika të ndryshme, që sipas mendimit të kryesuesit meritojnë të shqyrtohen në mbledhje.
3. Kuvendi mund të vendosë në mbledhje të punojë sipas propozimit të rendit të ditës, apo të njëjtin ta ndryshojë, duke bërë plotësime apo duke hequr ndonjë pikë të propozuar të rendit të ditës, përveç në rastet kur mbledhja e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesën e 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Kuvendit nuk mund të ndryshohet;
4. Kur rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve, shërbimi profesional për punë të Kuvendit duhet:
- 4.1 Ti dërgojë secilit këshilltar (anëtar) nga një kopje të materialit, i cili përmban shënime lidhur me çështjet të cilat do të shtrihen në mbledhje;
- 4.2 Në rastet e veçanta ti njoftojë anëtarët se materiali është i gatshëm në Zyrën e Shërbimit Profesional për Punët e Kuvendit, dhe atë mund ta tërheqin gjatë orëve të rregullta të punës.
5. Kur rendi i ditës caktohet, kryesuesi përmes Zyrës për Informim dhe Komunikim duhet të njoftojë publikun për atë se kopja e materialit që përmban shënime për çfarëdo çështje që do të shqyrtohen në mbledhje mund të shikohen ose të merren gjatë orëve të rregullta të punës në Sektorin e Shërbimit Profesional për Punët e Kuvendit dhe të komiteteve të Komunës.

Neni 8

Rregullat e diskutimit

1. Propozimi mund të diskutohet vetëm sipas radhës së miratuar të rendit të ditës.
2. Kur bëhen ndryshime, propozimi i ndryshuar zë vendin e propozimit paraprak dhe shndërrohet në propozim të rregullt, gjë që mund të propozohen edhe ndryshime të tjera.
3. Nëse dy ose më shumë anëtarë shprehin dëshirën të diskutojnë, kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e diskutuesve, ashtu që përparësi do ti jepet anëtarit i cili është më i moshuar. Anëtarët i drejtohen kryesuesit të mbledhjes, dhe gjatë diskutimit të tyre duhet tu përmbahen çështjeve që kanë të bëjnë me pikën për të cilën diskutohet. Në rast se nuk u përmbahen çështjeve që kanë të bëjnë me pikën, nga ana e kryesuesit duhet tu tërhiqet vërejtja, mirëpo, nëse as pas vërejtjes anëtarë nuk ndërpret diskutimin, atëherë kryesuesi mund ta ndërpresë atë.
4. Anëtarët diskutojnë sipas renditjes dhe kur u jepet fjala. Diskutimi i tyre duhet të dëgjohet. Vendimi i kryesuesit për dhënien e të drejtës për diskutim rreth pikave të renditura ose për parashtrimin e çështjeve nga rendi i ditës është vendimtar.
5. Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar nuk lejohet dhënia e propozimeve të tjera, përveç:

- 5.1. Ndryshimeve rreth propozimit që diskutohet;
 - 5.2. Propozimit të dhënë për të parandaluar çrregullimet;
 - 5.3. Propozimit për të përjashtuar publikun dhe mediat, duke u bazuar në dispozitat e nenit 45 al.3 të LVL-së;
 - 5.4. Propozimit për të kaluar në pikën sipas radhës së rendit të ditës;
 - 5.5. Propozimit i cili kërkon që çështja që diskutohet të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;
 - 5.6. Propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për në mbledhjen e ardhshme;
 - 5.7. Propozimit për ndërprerjen e mbledhjes.
6. Kryesuesi nuk do të lejojë të diskutohet për asnjë propozim tjetër, derisa të kryhet diskutimi nga të gjithë ata që janë paraqitur për diskutim rreth çështjes që është duke u diskutuar. Anëtarët për pikën e njëjtë që është duke u shqyrtuar kanë të drejtë vetëm një herë të diskutojnë. Shefat e grupeve parlamentare, rreth pikës së rendit të ditës që është duke u shqyrtuar diskutojnë të parët, sipas radhës që e cakton kryesuesi i mbledhjes. Diskutimet e shefave të grupeve parlamentare mund të zgjasin më së shumti 5 minuta. Ndërkaq, diskutimet e anëtarëve mund të zgjasin më së shumti 3 minuta, dhe vetëm një herë mund të diskutojnë për të njëjtën çështje.
- 6.1. Nëse gjatë diskutimit nga ana e anëtarit përmendet emri i ndonjë anëtari të pranishëm, apo subjekti politik në mënyrë drejtpërdrejt apo indirekt në seancë, anëtari i përmendur ka të drejtë replike më së shumti 1 minutë, dhe atë më së shumti dy herë për të njëjtën çështje;
 - 6.2. Diskutimet e anëtarëve prej vendit dhe pa lejen e kryesuesit nuk do të përfshihen në procesverbal;
 - 6.3. Gjatë punës në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të komisioneve dhe trupave të tjera punuese anëtarëve nuk u lejohej përdorimi i telefonave celularë për bisedë;
 - 6.4. Anëtari për opinionin, votimin dhe qëndrimin e tij të parashtruar në Kuvendin e Komunës nuk i nënshtrohet përgjegjësisë. Anëtarin nuk e përjashton nga përgjegjësia nëse gjatë diskutimit të vet përdor fjalë fyese, kërcënuese, shpifëse, diskriminuese në baza nacionale, fetare, gjinore, racore etj.
7. Kur ndonjë anëtar është duke diskutuar në mbledhje pjesëmarrësit tjerë qëndrojnë të ulur.
8. Nëse kryesuesi i mbledhjes qëndron në këmbë gjatë debatit të gjithë anëtarët tjerë duhet të qëndrojnë ulur dhe të heshtin.
9. Nëse ndonjë anëtar gjatë diskutimit propozon të ndryshojë apo të plotësojë diçka, propozimi i tillë hidhet në votim.
10. Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes kryesuesi duhet të respektojë parimin “që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë diskutimi të gëzojnë të drejtën e barabartë për pjesëmarrje në mbledhje”.

Neni 9

Grupimet e anëtarëve të Kuvendit sipas përcaktimeve politiko-partiake

1. Anëtarët e Kuvendit mund të grupohen në përputhje me përcaktimin e tyre politik e partiak.
2. Numri minimal për formimin e një grupi mund të jetë 3 anëtarë.
3. Anëtarët e Kuvendit nuk lejohet të formojnë grupin mbi bazë interesash lokale dhe etnike.
4. Anëtari i Kuvendit mund të marrë pjesë vetëm në një grupim politik.
5. Kushtet për anëtarësim në grup për largimin nga grupi, të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen brenda grupit me rregullat e vendosura mes tyre.

Neni 10

Grupimet e anëtarëve të Kuvendit sipas komiteteve të Kuvendit

1. Kuvendi i Komunës për interesa pune krijon në gjirin e vet komisione të përhershme e të përkohshme pune në fusha të ndryshme të veprimtarisë së vet. Komisionet përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Kuvendit.
2. Komisionet janë organe të Kuvendit, ato kryejnë detyra për njohjen e gjendjes, për realizimin e nismave dobiprurëse dhe kontrollimin e veprimtarisë së Kuvendit dhe të administratës komunale.
3. Si rregull Kuvendi përveç komiteteve të detyrueshme krijon edhe këto komitete të përhershme:
 - 3.1. Komitetin për shëndetësi dhe çështje sociale;
 - 3.2. Komitetin për planifikim, rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës;
 - 3.3. Komitetin për arsim, kulturë dhe rini;
 - 3.4. Komitetin për shërbime publike;
4. Një anëtar i Kuvendit mund të zgjidhet anëtar komisioni vetëm në një komision të përhershëm, si ekspertë ata mund të aktivizohen edhe në një komision tjetër, por pa të drejtë vote në të.
5. Drejtuesit e komiteteve mbajnë lidhje dhe koordinojnë punën me drejtuesit e komiteteve të tjera për të gjitha problemet që përfshihen nën juridiksionin e tyre.
6. Si rregull, komitetet e përhershme të punës së Kuvendit diskutojnë raporte, projekte e relacione të paraqitura nga ekzekutivi, por edhe nga ndërmarrjet dhe institucionet në varësi të komunës.

Neni 11

Ulja/vendosja e kuvendarëve dhe të ftuarve në sallë

1. Kryesuesi i Kuvendit dhe drejtuesit e grupeve të anëtarëve të Kuvendit përcaktojnë vendin e qëndrimit të anëtarëve të Kuvendit, titullarëve të Komunës dhe të ftuarve më poshtë.

2. Në pjesën ballore kryetari, zv. kryetari dhe zyrtarë i Kuvendit.
3. Në pjesën anësore, në të majtë të kryesisë zë vend kryesuesi dhe titullarët e komunës sipas rastit.
4. Në vijim të titullarëve të komunës zënë vend anëtarët e Kuvendit sipas grupimeve politike dhe sipas rezultatit të fituar në zgjedhjet vendore.
5. Në fund të sallës për aq vende sa ka mundësi salla vendosen karrige për të ftuarit dhe mediat elektronike dhe të shkruara.

Neni 12

Nënshkrimi dhe publikimi i akteve të Kuvendit

1. Të gjitha aktet që i miraton Kuvendi nënshkruhen brenda 5 ditëve nga dita e miratimit të tyre, në rastet kur janë bërë gabime me hedhjen e akteve të Kuvendit përmisimi i tyre është bërë me urdhër të kryesuesit të Kuvendit, pasi dëgjohej paraprakisht titullari që e ka paraqitur aktin ose përfaqësuesi i Kuvendit Komunal.
 - 1.1. Aktet e Kuvendit Komunal shpallën brenda 15 ditëve nga dita e miratimit të tyre;
 - 1.2. Aktet hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit;
 - 1.3. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre, subjekteve që përfshihen në to;
 - 1.4. Aktet e Kuvendit afishohen në vende publike të caktuara nga Kuvendi.

Neni 13

Raportet e kryetarit të Komunës, zv. kryetarit në Kuvendin e Komunës

1. Në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 58, pika j të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, kryetari i Komunës raporton para Kuvendit për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 6 muaj.
2. Kryetari i Komunës dhe drejtorët në administratën komunale marrinë fjalën në Kuvend nëse kërkohet nga anëtarët e asamblesë komunale, për të sqaruar ndonjë çështje konkrete.
3. Anëtari i Kuvendit që parashtron pyetje kryetarit, zv kryetarit, drejtorëve përgjigjen do ta marrë aty për aty-me gojë apo me shkrim , qoftë sqarim, njoftim , ndonjë fakt apo rrethanë tjetër.

Neni 14

Votimi

1. Përveç kur në Statut dhe në Rregullore përcaktohet ndryshe votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me ngritjen e dorës, vetëm nëse në mbledhje vendoset që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

2. Kur votimi është i hapur, para votimit secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, ku do të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar dhe emrat e atyre që abstenojnë.
3. Secili anëtarë mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet se si ai ka votuar për çështjen e caktuar ose nëse ai ka abstenuar.
4. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të gjithë anëtarët kanë vetëm një votë. Kryesuesi ka votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.
5. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përjashtimisht rasteve të miratimit të Statutit të Komunës, simboleve të komunës dhe vendimet për emërtimin apo riemërtimin e çfarëdo rrugice, rruge apo vendi tjetër publik ku vendimet merren me 2/3 (dy të tretat e votave) të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
6. Vendimi për miratimin apo për ndryshimin dhe plotësimin e rregullave të procedurave dhe rregulloreve tjera miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të kuvendit.
7. Kur ka nevojë të bëhet votimi i fshehtë, shërbimi profesional për punë të Kuvendit të gjithë anëtarëve me të drejtë vote do t'ua shpërndajë fletëvotimet të cilat përmbajnë propozimet e kandidatëve të renditur sipas alfabetit, duke u bazuar në mbiemrat e tyre. Shërbimi profesional për punë të Kuvendit duhet të sigurojë kutinë për votim e cila duhet të jetë e gatshme për përdorim në mbledhje. Votohet menjëherë në mbledhje duke shënuar afër propozimit për të cilin anëtari dëshiron të votojë, dhe e hedh votën në kutinë e votimit. Abstenimet regjistrohen nëse hidhet fletëvotimi i pamarkuar në kuti. Shërbimi profesional për punë i Kuvendit, pas përfundimit të votimit i numëron votat publikisht dhe menjëherë i deklaron rezultatet. Ai duhet ti mbajë fletëvotimet në vend të sigurt më së paku dymbëdhjetë muaj.

Neni 15

Kodi i mirësjelljes së anëtarëve në asamblenë komunale

1. Nëse në mbledhje konsiderohet se ndonjëri nga anëtarët nuk sillet mirë në mbledhje, pengon punën e mbledhjes me qëllim, duke mos respektuar urdhrat e kryesuesit, ose sillet në mënyrë ofenduese apo cinike, kryesuesi duhet t'ia tërheqë vërejtjen. Nëse sjelljet e anëtarit në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, kryesuesi i mbledhjes mund të ndër marrë një rrënjë prej këtyre masave, veçmas ose si varg masash:
 - 1.1. U propozon të pranishmëve në mbledhje që anëtari të mos dëgjohet, me ç'rast propozimi duhet të bëhet menjëherë në mbledhje, pa nevojë për kraheje dhe nëse propozimi miratohet anëtarit i ndalohe diskutimi i mëtutjeshëm në mbledhje;
 - 1.2. Udhëzon anëtarin e Kuvendit-Komitetit të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime;
 - 1.3. Jep urdhrin që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime;
 - 1.4. Shtyn mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin që mund të caktohet më vonë.

Neni 16

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve të Kuvendit janë:
 - 1.1. tërheqje vëmendje;
 - 1.2. vërejte;
 - 1.3. marrja e fjalës;
 - 1.4. përjashtimi nga mbledhja e Kuvendit, mbledhja e komiteteve dhe komisioneve.

Neni 17

Ndërprerja dhe shtyrja e seancave

1. Kryesuesi i Kuvendit, kur mendon ai ose me kërkesën e një grupi përkatës në Kuvend, mund ta ndërpresë mbledhjen, por jo më shumë se 30 minuta.
2. Rastet për të cilat mund të ndërpritet mbledhja e Kuvendit mund të jenë:
 - 2.1. Kur pushimi gjatë mbledhjes (pauza) zgjatë më shumë se 30 minuta;
 - 2.2. Kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve bie nën numrin e paraparë për mbajtjen e mbledhjes;
 - 2.3. Kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje e njëjta nuk mund të kryhet atë ditë;
 - 2.4. Kur vjen gjerë te prishja e rëndë e rendit të punës, por që kryesuesi nuk është në gjendje ta kthejë në gjendje normale punën e mbledhjes së Kuvendit me masa disiplinore;
 - 2.5. Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim më të madh, kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë ta lirojnë sallën e mbledhjes dhe mbledhjen mund ta shtyjë për një orë, ose deri në kohën, datën dhe vendin që mund të caktohet më vonë.
2. Për shtyrjen e mbledhjes së Kuvendit vendos kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit.

Neni 18

Konflikti i interesit

1. Në rast se gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Kuvendit, anëtarit të komitetit, paraqet mospajtim ndërmjet detyrës publike dhe interesave private, do të zbatohet neni 38 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.
2. Në rast se ekziston konflikti i interesit, dhe gjatë procedurës së vendimmarrjes i njëjti nuk është vërejtur, apo anëtari i Kuvendit apo komitetit nuk e ka paraqitur atë, atëherë organi që ka marrë vendim e anulon të njëjtën dhe vendos rishtas për atë çështje.

Neni 19

Gjuhët e përdorura në Kuvend dhe dokumente

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthim sipas nevojës.
2. Të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën shqipe, sipas nevojës edhe në gjuhën e komunitetit të cilit i referohet dokumenti.

Neni 20

Procedura e ndryshimit

1. Procedurën për ndryshimin e kësaj rregulloreje mund ta iniciojë kryesuesi dhe çdo anëtar i Kuvendit me 1/3 e anëtarëve të Kuvendit. Procedura e ndryshimit të rregullores së punës është si vijon:
 - 1.1. Çdo propozim a nismë për ndryshimin e rregullores së punës duhet të shqyrtohet dhe atë pasi të miratohet nga Komiteti për Politikë dhe i Financa;
 - 1.2. Propozimi për shqyrtim dhe për miratim duhet ti paraqitet Kuvendit të Komunës së Vitisë. Nëse propozimi nuk refuzohet nga Kuvendi, Kuvendi do të ndërmarrë konsultime në lidhje me propozimin siç është paraparë me Statut;
 - 1.3. Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës e merr Kuvendi, me shumicën e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 21

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

1. Që nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë nr.01-013/4905, të datës 29.10.2008. Kjo Rregullore hyn në fuqi që nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.



Kryesuesi i Kuvendit
z.Naim Pira